

Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave **2024**



Korrik 2025

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4	Kaçanik	17
Metodologjia	5	Klinë	18
Gjetjet kryesore për vitin 2024	6	Lipjan	19
Analiza e performancës së komunave – indeksi i vitit 2024 krahasuar me indeksin e vitit 2023	10	Mitrovicë e Jugut	20
Përfundime dhe rekomandime	14	Prizren	21
		Rahovec	22
		Shtime	23
		Skënderaj	24
		Vushtrri	25
		Drenas	26
		Hani i Elezit	27
		Podujevë	28
		Viti	29
		Istog	30
		Suharekë	31
		Dragash	32
		Prishtinë	33
		Deçan	34
		Mitrovicë e Veriut	35
		Junik	36
		Kamenicë	37
		Pejë	38
		Malishevë	39
		Gjilan	40
		Gjakovë	41
		Ferizaj	42
		Obiliq	43
		Fushë Kosovë	44
		Partesh	45
		Novobërdë	46
		Mamushë	47
		Shtërpcë	48
		Ranillug	49
		Graçanicë	50
		Leposaviç	51
		Klllokot	52

Përmbledhje ekzekutive

Indeksi i Transparencës Buxhetore vlerëson nivelin e transparencës buxhetore të komunave për vitin 2024, duke përdorur metodologji të njëjtë për të gjitha komunat. Indeksi përditësohet nga viti 2017 dhe synon të rrisë llogaridhënien dhe qasjen e qytetarëve në informacionet buxhetore në nivel lokal.

Në vitin 2024, transparenca buxhetore në komuna tregoi përmirësim krahasuar me vitin 2023. Mesatarja e indeksit të transparencës u rrit në 61 pikë nga 57.5 në 2023. Gjithsej 22 komuna kaluan mesataren e pikëve në indeks. Nëntë prej tyre arritën pikët maksimale (100 pikë), përkatësisht komunat e Kaçanikut, Klinës, Lipjanit, Mitrovicës së Jugut, Prizrenit, Rahovecit, Shtimës, Skënderajt dhe Vushtrrisë.

Gjatë vitit 2024, komunat kanë publikuar gjithsej 227 dokumente buxhetore, përfshirë raporte financiare dhe dokumente mbështetëse të politikave buxhetore. Nga 38 komunat e vlerësuara, 28 kanë mbajtur të paktën katër dëgjime buxhetore, tri komuna kanë mbajtur nga tri dëgjime buxhetore, dhe një komunë ka mbajtur vetëm një dëgjim buxhetor. Ndërkohë, gjashtë komuna nuk kanë mbajtur asnjë dëgjim buxhetor. Sa i përket formateve të publikuara, 168 (74%) dokumente janë publikuar në formate lehtë të lexueshme si 'Excel' apo 'Word', 47 dokumente (21%) janë në formë të skanuar, dhe 10 dokumente (4%) janë në format 'PDF'. Dokumentet më të publikuara nga komunat kanë qenë Korniza Afatmesme Buxhetore 2025–2027 dhe listat e përfituesve të subvencioneve.

Sipas kërkesave të udhëzimit administrativ për administratë të hapur në komuna, 29 komuna kanë publikuar kornizën afatmesme buxhetore (KAB), 25 komuna kanë publikuar raportet financiare për tremujorin e parë (TM1) dhe të tretë (TM3), dhe 26 komuna kanë publikuar raportin financiar për tremujorin e dytë (TM2). Më tej, 24 komuna kanë publikuar raportin vjetor financiar për 2024. Po ashtu, gati se çdo vit po vërehet një përmirësim në publikimin e kartelës analitike të kontos, si një dokument kyç që ofron të dhëna të detajuara financiare rreth shpenzimit të buxhetit të komunës. Konkretisht, këtë vit 18 komuna e kanë publikuar këtë dokument në ueb-faqet e tyre apo ofruar përmes kërkesës, krahasuar me 14 në vitin paraprak.

Mitrovica e Veriut dhe Vitia kishin ngritjet më të mëdha në Indeks në vitin 2024, përkatësisht grumbulluan 46 dhe 45 pikë më shumë krahasuar me vitin 2023. Deçani dhe Parteshi gjithashtu kanë përmirësuar dukshëm performancën e tyre. Ferizaj ka pësuar rënien më të madhe me 47.5 pikë më pak se në vitin 2023. Gjithashtu, edhe Malisheva, Suhareka, Gjakova dhe Obiliqi kanë ulje në pikë. Zubin Potoku dhe Zveçani vazhdojnë të mos publikojnë asnjë dokument buxhetor, duke mbetur ndër komunat më jotransparente në vend.

Metodologjia

Indeksi i Transparencës Buxhetore është një raport më anë të të cilit Instituti GAP vlerëson transparencën buxhetore të komunave, duke përdorur metodologji të standardizuar për të gjitha komunat. Indeksi përditësohet që nga viti 2017 dhe synon të rrisë llogaridhënien dhe qasjen e qytetarëve në informacionet buxhetore në nivel lokal. Ky raport përfshin vlerësimin e publikimit të dokumenteve që komunat janë të detyruara t'i publikojnë sipas legjislacionit aktual, vlerësimin e publikimit të disa dokumenteve të tjera buxhetore që u ofrojnë qytetarëve më shumë informacion mbi përdorimin e fondeve publike, si dhe formatin e publikimit të tyre.¹

Mbledhja e të dhënave për publikimin e dokumenteve është bërë duke kërkuar nga komunat të plotësojnë një pyetësor me vegëzat e dokumenteve të publikuara në ueb-faqet e tyre zyrtare. Gjatë muajit maj 2025, Instituti GAP ka dërguar kërkesa te zyrat komunale për komunikim me publikun, ndërsa monitorimi i faqeve të komunave ka përfunduar në qershor 2025. Nga 38 komunat e Kosovës, 22 prej tyre janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 16 komuna nuk kanë dhënë përgjigje. Për komunat që nuk janë përgjigjur, vlerësimi është bërë në bazë të informatave të gjetura në ueb-faqet e tyre, duke përjashtuar dokumentet që nuk janë gjetur me tri klikime në fushën e dedikuar për publikimin e raporteve të buxhetit.² Për dallim nga vlerësimi i kaluar, tani janë të lansuara ueb-faqet e reja të komunave, gjë që ka ndihmuar në një funksionim dukshëm më të mirë të ueb-faqeve krahasuar me vitet paraprake dhe lehtësuar qasjen në dokumente dhe informata për qytetarët.

Institucionet janë të obliguara të publikojnë çdo dokument publik të përfunduar, pavarësisht nëse qytetarët kanë bërë kërkesë për qasje ose jo. Sipas Udhëzimit administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për administratë të hapur në komuna³, komunat janë përgjegjëse për publikimin e raporteve financiare në ueb-faqet e tyre përfshirë planin e buxhetit dhe planet investuese, raportet tremujore të shpenzimeve, Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), raportin përmbledhës të buxhetit të komunës për vitin e kaluar fiskal, si dhe raportin e auditorit mbi buxhetin e komunës për vitin e kaluar fiskal. Ndërkaq lidhur me dëgjimet buxhetore, sipas të njëjtit udhëzim, komunat janë të obliguara të organizojnë të paktën nga një takim publik⁴ rreth KAB dhe projektbuxhetit meqë këto dokumente cilësohen si akte obligative për konsultime publike⁵. Po ashtu, për projektbuxhetin e komunës, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë obligon kuvendin komunal të mbajë dëgjime buxhetore me qytetarë.⁶ Në përgjithësi, udhëzimi administrativ më lartë për administratë të hapur në komuna, ndonëse duke mos i kuantifikuar në numër, nxitë komunat që të mbajnë dëgjime buxhetore⁷ dhe takime tjera publike të numërta rreth investimeve të komunës, zhvillimit ekonomik lokal, dhe më shumë.⁸ Po ashtu, ndonëse jo e shpeshtë si praktikë, ka raste kur edhe qarkoret buxhetore i obligojnë komunat të mbajnë dëgjime buxhetore.⁹

1 Për më shumë informata rreth metodologjisë së llogaritjes të Indeksit, shihni raportin për Indeksin e Transparencës Buxhetore të vitit 2023: [https://www.institutigap.org/documents/16108_indeksi_transparences_2023\(shq\).pdf_dhe_platformen](https://www.institutigap.org/documents/16108_indeksi_transparences_2023(shq).pdf_dhe_platformen): <https://institutigap.org/transparenca-buxhetore?year=2023>

2 Nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, deri më tani nuk kanë kthyer përgjigje në kërkesën tonë 16 prej tyre: Fushë Kosova, Gjakova, Graçanica, Juniku, Kllokoti, Malisheva, Mamusha, Novobërda, Obiliqi, Parteshi, Prishtina, Ranillugu, Shtërpca, Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi.

3 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). [Udhëzimi administrativ nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna](#). Neni 17 dhe 18.

4 Që në këtë rast ka kuptimin e dëgjimit buxhetor. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). [Udhëzimi administrativ nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna](#). Neni 26.2

5 Po aty. Neni 22.1.4 dhe Neni 22.1.5

6 [Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë](#). Neni 61.2

7 Po aty. Neni 31

8 Po aty. Neni 18.3

9 Sikurse në vitin 2016.

Gjetjet kryesore për vitin 2024

Transparenca buxhetore e krijon një mjedis mbikëqyrës dhe llogaridhënës, prandaj edhe është thelbësore për t'i siguruar qytetarët se taksat e tyre po shpenzohen në mënyrë të drejtë dhe në përputhje të plotë me ligjet.


Në vitin 2024, transparenca buxhetore në komuna pati një përmirësim krahasuar me vitin 2023. Mesatarja e indeksit të transparencës u rrit nga 57.5 në 61 pikë. Përmirësimi i rezultateve u ndikua nga arritja e pikëve maksimale nga më shumë komuna, çka kontribuoi në rritjen e mesatares së përgjithshme. Ndër faktorët kyç ishte edhe përmirësimi në funksionalitetin dhe disponueshmërinë e uebfaqeve komunale, të cilat në vlerësimin e vitit 2023 ishin identifikuar si problematike. Për më tepër, në vlerësimin e vitit 2024 u përfshinë të gjitha komunat, duke siguruar kështu një analizë gjithëpërfshirëse të transparencës buxhetore në nivel lokal.

Gjatë vitit 2024, gjithsej 22 komuna nga 38, që përbëjnë 57% të totalit, kaluan mesataren e pikëve në indeksin e transparencës buxhetore. Nëntë prej tyre arritën pikët maksimale prej 100, përkatësisht komuna e Kaçanikut, Klinës, Lipjanit, Mitrovicës së Jugut, Prizrenit, Rahovecit, Shtimës, Skënderajt dhe Vushtrrisë. Këto komuna publikuan të gjitha dokumentet buxhetore në formatin 'Excel' ose 'Word'. Komuna e Drenasit, Hanit të Elezit dhe Podujevës kanë shfaqur gjithashtu një nivel të lartë transparence buxhetore, secila me 95 pikë. Në të tri rastet, arsyeja që nuk kanë marrë maksimumin lidhet me formatin e skanuar të njërës nga dokumentet e vlerësuara nga indeksi në uebfaqet përkatëse komunale.

Gjithsej, nëntë komuna (24%) bëjnë pjesë në kuartilin e lartë me mbi 95 deri në 100 pikë, dhjetë komuna (26%) në kuartilin e mesëm të lartë me mbi 70 deri në 95 pikë, nëntë komuna (24%) në kuartilin e mesëm të ulët me mbi 20 deri në 70.5 pikë, dhe 10 komuna (26%) në kuartilin e ulët me më nga zero deri në 20 pikë.


Figura 1. Figura 1. Indeksi i transparencës buxhetore të komunave 2024

Burimi: Instituti GAP



Sipas rezultateve të indeksit për transparencën buxhetore për vitin 2024, komunat kanë publikuar gjithsej 227 dokumente buxhetore, përfshirë raporte financiare dhe dokumente mbështetëse të politikave buxhetore, si rregullorja për ndarjen e subvencioneve. Nga 38 komunat e vlerësuara, 32 prej tyre kanë organizuar së paku 123 dëgjime buxhetore. Më konkretisht, 28 komuna kanë mbajtur të paktën katër dëgjime, tri komuna kanë mbajtur nga tre dëgjime dhe një tjetër vetëm një dëgjim. Ndërkohë, gjashtë komuna nuk kanë mbajtur asnjë dëgjim buxhetor. Listat e përfituesve të subvencioneve janë publikuar nga 25 komuna, ndërsa rregullorja për ndarjen e subvencioneve është bërë publike nga 28 komuna. Sa i përket formateve të dokumenteve të publikuara, 168 prej tyre (74%) janë në formate lehtë të lexueshme si 'Excel' apo 'Word', 47 dokumente (21%) janë në formë të skanuar, dhe 10 dokumente (4%) janë në format 'PDF'. Ndërsa, përmes kërkesave zyrtare për qasje përmes e-mailit është pranuar dokumenti i kartelës analitike të kontos nga dy komuna (1%).

Figura 2. Figura 3. Dokumentet e publikuara nga 36 komunat sipas formatit të publikimit (në përqindje)



Burimi: Instituti GAP

Gjatë vitit 2024, dokumentet më të publikuara nga komunat kanë qenë Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 dhe listat e përfituesve të subvencioneve. Sa i përket formateve të publikimit, raporti financiar për tremujorin e parë të vitit 2024 dhe buxheti i planifikuar për vitin 2025 janë ndër dokumentet që janë publikuar më shumë në formate si 'Excel' ose 'Word'. Ndërkohë, listat e përfituesve të subvencioneve, rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara janë publikuar kryesisht në format 'PDF i skanuar'.

Sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së për administratë të hapur në komuna, korniza afatmesme buxhetore (KAB) është publikuar nga 29 komuna, ndërsa raporti financiar për tremujorin e dytë (TM2) është publikuar nga 26 komuna. Për më shumë, 25 komuna kanë publikuar raportet financiare për tremujorin e parë (TM1) dhe të tretë (TM3). Si dhe, raporti vjetor financiar për 2024 është publikuar nga 24 komuna. Megjithëse konsiderohet një nga dokumentet më të rëndësishme për llogaridhënie financiare dhe vlerësohet me pikët maksimale në këtë indeks, kartela analitike e kontos ende mbetet ndër dokumentet më pak të publikuara. Gjithsej, 16 komuna e kanë bërë publik këtë dokument në ueb-faqet e tyre, dhe dy komuna të tjera e kanë dërguar me e-mail me kërkesë. Megjithatë, vërehet një përmirësim me vitin paraprak meqë ky dokument është publikuar nga më shumë komuna (gjithsej 14 komuna në vitin 2023).

Tabela 1. Tabela 2. Dokumentet e publikuara të indeksit për transparencë buxhetore komunale 2024

	Excel	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa	Gjithsej
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	22	2	3		27
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	16			2	18
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027	22	1	6		29
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	13	2	10		25
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	21	1	3		25
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	26				26
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	23		2		25
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	19	1	4		24
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	6	3	19		28
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2025					123
Numri i komunave që i kanë publikuar kontratat e nënshkruara 2024					27

Burimi: Instituti GAP

Bazuar në formatin e publikimit të dokumenteve buxhetore, komuna e Kaçanikut, Rahovecit dhe Vushtrrisë i kanë publikuar të gjitha dokumentet përkatëse në formate si 'Excel' ose 'Word', duke mundësuar kështu një qasje më të lehtë, analizë dhe ripërdorim më efikas të të dhënave. Ndërkaq, komuna e Klinës, Lipjanit, Mitrovicës së Jugut, Prizrenit, Shtimës dhe Skenderajt i kanë publikuar shumicën e dokumenteve buxhetore në formate si 'Excel' ose 'Word', por dokumente të caktuara si rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara i kanë ofruar vetëm në formatin 'dokument i skanuar', gjë që kufizon qasjen për analizë në përmbajtje. Në anën tjetër, komuna e Klllokotit, Novobërdës, Obiliqit, Parteshit dhe Ranillugut i kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore vetëm në formatin 'dokument i skanuar', gjë që vështirëson përdorimin dhe krahasimin e të dhënave nga ana e qytetarëve apo monitoruesve të pavarur.

Analiza e performancës së komunave – indeksi i vitit 2024 krahasuar me indeksin e vitit 2023

Në indeksin e transparencës buxhetore për vitin 2024, nëntë komuna kanë arritur vlerësimin maksimal prej 100 pikësh, që përbën numrin më të lartë të komunave me këtë rezultat që prej fillimit të matjes së transparencës buxhetore në nivel lokal. Komunat që kanë arritur këtë vlerësim janë Kaçaniku, Klina, Lipjani, Mitrovica e Jugut, Prizreni, Rahoveci, Shtimja, Skënderaj dhe Vushtrria. Krahasuar me vitin 2023, Lipjani dhe Vushtrria kanë ruajtur rezultatin maksimal, Klina ka grumbulluar 20 pikë më shumë, ndërsa Kaçaniku dhe Rahoveci nga gjashtë pikë më shumë. Mitrovica e Jugut, Prizreni dhe Skënderaj, të cilat nuk ishin përfshirë në vlerësimin e vitit 2023 për shkak të problemeve teknike me ueb-faqet zyrtare, gjatë vitit 2024 kanë grumbulluar 100 pikë, njejtë si në vitin 2022. Të gjitha këto komuna renditen në kuartilin e lartë të indeksit, duke zënë pozitat më të larta në renditje.

Një nivel të lartë të transparencës kanë treguar edhe komuna e Drenasit, Hanit të Elezit dhe Podujevës, të cilat kanë grumbulluar nga 95 pikë secila. Drenasi dhe Hani i Elezit kanë shënuar një rënie prej pesë pikësh krahasuar me vitin 2023, ndërsa Podujeva ka përmirësim prej 15 pikësh. Rënia e pikëve në Drenas dhe Han të Elezit është ndikuar kryesisht nga publikimi i listave të përfituesve të subvencioneve në format të skanuar, që e kufizon përdorimin dhe qasjen efektive në të dhëna.

Progresin më të madh në indeksin e këtij viti e ka pasur Komuna e Mitrovicës së Veriut me 46 pikë më shumë se në vitin e kaluar dhe një ngritje prej 7 vendeve në renditje. Ngjashëm, edhe Komuna e Vitisë ka pasur përmirësim me gjithsej 90 pikë të mbledhura në indeks, apo 45 pikë më shumë se në vitin e kaluar, dhe Komuna e Deçanit me 12.5 pikë më shumë, e cila ka rezultuar në një ngritje prej 13 vendeve në renditje. Ndërkaq, Komuna e Parteshit, e cila në vitin 2023 kishte një rezultat prej zero pikësh, në vitin 2024 ka arritur të grumbullojë 20 pikë dhe të renditet për 13 pozita më lartë. Këto ndryshime dëshmojnë përpjekje të dukshme të disa komunave për të përmirësuar transparencën në publikimin e dokumenteve buxhetore dhe angazhimin në proceset e llogaridhënies publike.

Ndërsa disa komuna shënuan përmirësime të dukshme në transparencën buxhetore gjatë vitit 2024, disa të tjera patën regres. Komuna e Ferizajt ka grumbulluar 47.5 pikë më pak krahasuar me vitin 2023 dhe u rendit në vendin e 26-të, me një rënie prej 21 vendeve në renditje. Tutje, komuna e Obiliqit ka grumbulluar 25 pikë më pak krahasuar me vitin e kaluar, komuna e Malishevës 25 pikë më pak, e Gjakovës me 20 pikë më pak dhe e Suharekës me 10 pikë më pak. Ky regres në rezultat më së shumti është ndikuar nga mospublikimi i disa prej dokumenteve të buxhetit, dhe në raste më të rralla, nga formati i publikimit të tyre.

Nga ana tjetër, komunat si Zubin Potoku dhe Zveçani nuk kanë shfaqur asnjë përmirësim dhe vazhdojnë të mos publikojnë asnjë dokument buxhetor në ueb-faqet e tyre zyrtare, duke u pozicionuar si ndër komunat më jotransparente në nivel lokal. Ky stagnim i theksuar dhe mungesa e angazhimit të këtyre komunave për informim publik mbeten sfiduese në kontekstin e llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë.

Tabela 2. Tabela 4. Renditja e komunave sipas pikëve për vitin 2024 (me renditje alfabetike për pikë të barabarta, krahasuar me vitin 2023)

Nr. Rendor	Komuna	Pikët 2024	Pikët 2023	Rangimi 2024	Rangimi 2023
1	Kaçanik	100	94	1	7
2	Klinë	100	80	1	11
3	Lipjan	100	100	1	1
4	Mitrovicë e Jugut	100	/	1	/
5	Prizren	100	/	1	/
6	Rahovec	100	94	1	7
7	Shtime	100	75	1	14
8	Skënderaj	100	/	1	/
9	Vushtrri	100	100	1	1
10	Drenas	95	100	10	1
11	Hani i Elezit	95	100	10	1
12	Podujevë	95	80	10	11
13	Viti	90	45	13	21
14	Istog	85	72.5	14	15
15	Suharekë	85	95	14	5
16	Dragash	75.5	83.5	16	9
17	Prishtinë	75.5	75.5	16	13
18	Deçan	75	62.5	18	19
19	Mitrovicë e Veriut	71	25	19	26
20	Junik	70	68.5	20	17
21	Kamenicë	67.5	/	21	/
22	Pejë	62.5	/	22	/
23	Malishevë	57.5	82.5	23	10
24	Gjilan	53.5	58.5	24	20
25	Gjakovë	52	72	25	16
26	Ferizaj	47.5	95	26	5
27	Obiliq	40	65	27	18
28	Fushë Kosovë	24.5	41.5	28	22
29	Partesh	20	0	29	30
30	Novobërdë	17.5	35	30	23
31	Mamushë	15	20	31	27
32	Shtërpcë	15	27.5	31	24
33	Ranillugë	12.5	12.5	33	28
34	Graçanicë	10	25.5	34	25

35	Leposaviq	7.5	0	35	30
36	Klllokot	5	12.5	36	28
37	Zubin Potok	0	0	37	30
38	Zveçan	0	0	37	30

Burimi: Instituti GAP

*Shënim: Shenja (/) tregon se komuna përkatëse nuk ishte e përfshirë në vlerësimin e vitit 2023 të Indeksit të Transparencës Buxhetore.

Në vitin 2024, komunat shënuan përmirësim në transparencën buxhetore, pas rënies së theksuar në vitin 2023. Numri i komunave që publikojnë dokumente të rëndësishme është rritur, duke reflektuar një përkushtim më të madh institucional për pjesëmarrje publike dhe informim të qytetarëve. Janë mbajtur të paktën 32 dëgjime buxhetore më shumë sesa vitin e kaluar. Në aspektin e transparencës së shpërndarjes së subvencioneve, është shënuar përmirësim (gjashtë komuna më shumë sesa vitin e kaluar), përmes publikimit të dokumenteve që pasqyrojnë përfituesit dhe shumën e ndarë të subvencioneve.

Sa i përket dokumenteve specifike, është vërejtur përmirësim në publikime, sikurse për kornizën afatmesme buxhetore (pesë komuna më shumë), për buxhetin e planifikuar për vitin pasues (katër komuna më shumë), si dhe për kartelat analitike të shpenzimeve (katër komuna më shumë, dy nga të cilat i kemi pranuar me kërkesë). Megjithatë, shumica e dokumenteve nuk janë rikthyer ende në nivelet e publikimit të vitit 2022, veçanërisht raporti vjetor financiar dhe rregullorja për ndarjen e subvencioneve. Një ndër praktikatat më pozitive të vitit 2024 mbetet organizimi i më shumë dëgjimeve buxhetore me qytetarë.

Tabela 3. Tabela 5. Numri i publikimit të dokumenteve dhe dëgjimeve buxhetore nga komunat

Dokumenti	2020	2021	2022	2023	2024
Raporti financiar TM 1 për vitin aktual	28	28	31	24	25
Raporti financiar TM 2 për vitin aktual	29	30	32	22	26
Raporti financiar TM 3 për vitin aktual	29	24	29	24	25
Raporti vjetor financiar për vitin e fundit	30	29	29	27	24
Buxheti i planifikuar për vitin pasardhës	34	28	31	23	27
Korniza Afatmesme Buxhetore	32	29	32	24	29
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	32	30	30	27	25
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin aktual	24	20	29	22	28
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin aktual	7	8	14	14	18
Dëgjime buxhetore me qytetarë për vitin pasardhës	84	106	130	91	123

Burimi: Instituti GAP

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) përfshin integrimin e një perspektive të qartë gjinore në kuadër të procesit buxhetor në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe përfshin zbatimin e analizës gjinore në formulimin, zbatimin dhe vlerësimin e buxheteve publike. Përfshirja e perspektivës gjinore në buxhetin komunal ndihmon në krijimin e politikave dhe programeve që pasqyrojnë nevojat dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave,

duke promovuar kështu barazinë gjinore dhe përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët. Në Kosovë, barazia gjinore është e garantuar nga Kushtetuta, por në praktikë shoqëria mbetet diskriminuese ndaj grave, si në politikë, në tregun e punës, ashtu edhe në përfitimet nga fondet publike. Sipas Ligjit Nr. 05/L-020 për barazi gjinore, institucionet e Kosovës janë të detyruara të përfshijnë buxhetimin gjinor në të gjitha këto aspekte.¹⁰

Megjithëse buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është i paraparë si obligim nga Ligji për barazi gjinore që nga viti 2015 dhe është kërkesë e Ministrisë së Financave përmes qarkoreve të buxhetit që nga viti 2018, deri më tani nuk është përfshirë si komponent i veçantë në vlerësimin me pikë të Indeksit të Transparencës Buxhetore.¹¹ Kjo ka ndodhur për shkak se zbatimi i tij ka qenë relativisht i panjohur për komunat, ka munguar një standardizim i qartë në formatin dhe përmbajtjen e këtyre dokumenteve, dhe nuk ka pasur indikatorë të qartë për matjen e cilësisë së përmbajtjes së tyre. Prandaj, deri në këtë vit është trajtuar si një element vëzhgues dhe informues, por jo si pjesë e pikëzimit.

Sipas rezultateve të indeksit, në vitin 2024, nga gjithsej 38 komuna, vetëm 17 kanë publikuar dokumente të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Kjo përfaqëson një ulje prej tre komunash krahasuar me vitin 2023 dhe tregon një regres në transparencën gjinore në nivel lokal. Komunitat si Ferizaj, Gjakova, Kaçaniku, Lipjani, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Shtimja dhe Skenderaj përfaqësojnë praktikat më pozitive në këtë fushë. Këto komuna kanë ndërtuar një qasje konsistente përgjatë katër viteve të fundit, duke integruar perspektivën gjinore në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Në vitin 2024, vetëm 14 komuna kanë publikuar dokumente të BPGJ, apo 11 më pak se në vitin 2023. Për dallim nga viti 2023, në 2024 dokumentet të BPGJ nuk kanë publikuar komuna si: Dragashi, Gjilani, Istogu, Juniku, Kamenica, Peja, Podujeva, Prishtina, Prizreni, Vitia dhe Suhareka. Në anën tjetër, pesë komuna si Deçani, Drenasi, Hani i Elezit, Klina dhe Mitrovica e Veriut shfaqin një përmirësim. Megjithatë, mbetet një grup prej 12 komunash që nuk kanë publikuar asnjëherë dokumente të BPGJ gjatë katër viteve të fundit. Në këtë kategori bëjnë pjesë: Fushë Kosova, Graçanica, Klllokoti, Leposaviqi, Mamusha, Novobërda, Parteshi, Rahoveci, Ranillugu, Shtërpca, Zubin Potoku dhe Zveçani.

Tabela 4. Tabela 6. (Mos)publikimi i dokumenteve për buxhetim të përgjegjshëm gjinor nga komunat

Komuna	2021	2022	2023	2024
Deçan	✗	✓	✗	✓
Dragash	✗	✓	✓	✗
Drenas	✓	✓	✗	✓
Ferizaj	✓	✓	✓	✓
Fushë Kosovë	✗	✗	✗	✗
Gjakovë	✓	✓	✓	✓
Gjilan	✓	✓	✓	✗
Graçanicë	✗	✗	✗	✗
Hani i Elezit	✗	✓	✗	✓
Istog	✓	✓	✓	✗
Junik	✓	✓	✓	✗
Kaçanik	✓	✓	✓	✓
Kamenicë	✗	✓	✓	✗

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji Nr. 05/L-020 për barazi gjinore](#). Neni 3. Pika 1.17.

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. [Ligji Nr. 05/L-020 për barazi gjinore](#); Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Qarkoret buxhetore 2019/01, 2018.

Klinë	✗	✗	✗	✓
Kllokot	✗	✗	✗	✗
Leposaviq	✗	✗	✗	✗
Lipjan	✓	✓	✓	✓
Malishevë	✓	✓	(kërkesë)	✗
Mamushë	✗	✗	✗	✗
Mitrovicë e Jugut	✓	✓	✓	✓
Mitrovicë e Veriut	✗	✗	✗	✓
Novobërdë	✗	✗	✗	✗
Obiliq	✓	✓	✓	✓
Partesh	✗	✗	✗	✗
Pejë	✓	✓	✓	✗
Podujevë	✗	✓	✓	✗
Prishtinë	✓	✓	✓	✗
Prizren	✓	✓	✓	✗
Rahovec	✗	✗	✗	✗
Ranillug	✗	✗	✗	✗
Shtërpçë	✗	✗	✗	✗
Shtime	✓	✓	✓	✓
Skenderaj	✓	✓	✓	✓
Suharekë	✓	✓	(kërkesë)	✗
Viti	✓	✓	✓	✗
Vushtrri	✓	✓	✓	✓
Zubin Potok	✗	✗	✗	✗
Zveçan	✗	✗	✗	✗

Burimi: Instituti GAP

Përfundime dhe rekomandime

Në vitin 2024, numri i komunave që kanë arritur pikët maksimale në Indeksin e Transparencës Buxhetore ka qenë më i larti që prej vitit 2017, kur ka filluar vlerësimi sistematik i transparencës buxhetore në nivel lokal. Ky rezultat pasqyron përkushtimin në rritje të disa komunave për të përmbushur standardet e llogaridhënies publike dhe për të rritur qasjen e qytetarëve në informata financiare. Përgjatë këtij viti është rritur numri i dokumenteve buxhetore të publikuara në faqet zyrtare të komunave, duke përfshirë dokumentet si korniza afatmesme buxhetore, buxhetet e planifikuara, raportet financiare dhe listat e subvencioneve. Po ashtu, është shënuar një përmirësim i mesatares së pikëve në indeks, duke reflektuar një trend pozitiv në nivel të përgjithshëm. Rritja e numrit të dëgjimeve buxhetore të mbajtura me qytetarë tregon se komunat po ndërmarrin hapa më të qartë drejt një qeverisjeje më gjithëpërfshirëse dhe të hapur.

Progresin më të madh e kanë shënuar komunat si Mitrovica e Veriut dhe Viti, të cilat kanë përmirësuar dukshëm performancën e tyre krahasuar me vitin e kaluar. Deçani dhe Parteshi kanë treguar gjithashtu progres. Megjithatë, përkundër këtyre përmirësimeve,

disa komuna si Ferizaj, Malisheva, Suhareka, Gjakova dhe Obiliqi kanë shfaqur regres të theksuar, ndërsa Zubin Potoku dhe Zveçani vazhdojnë të mos publikojnë asnjë dokument buxhetor.

Këto rezultate nënvizojnë se, ndonëse trendi i përgjithshëm është pozitiv, ekziston ende një hapësirë e konsiderueshme për përmirësim të performancës në shumicën e komunave. Në këtë drejtim, është e nevojshme që komunat të ndërmarrin hapa konkretë për të garantuar një transparencë më të lartë.

Për të përmirësuar transparencën buxhetore, Instituti GAP rekomandon që:

- Të rishikohet baza ligjore ashtu që institucionet publike, në këtë rast komunat, të obligohen që veçmas dokumentet buxhetore t'i publikojnë në formate lehtë të përdorshme, sikurse 'Excel' apo 'Word', meqë prej vitesh një numër i madh i dokumenteve buxhetore vazhdojnë të publikohen në versione si PDF apo PDF i skanuar.
- Komunat të sigurohen që të kenë kapacitete adekuate njerëzore dhe teknike për publikimin e rregullt të dokumenteve buxhetore, gjithmonë në seksione të njëjta dhe të lehta për navigim në ueb-faqet zyrtare. Gjetjet e vlerësimit të sivjetshëm dhe ato të mëhershme tregojnë raste të shumta kur komunat bien ndjeshëm në rangim nga viti në vit, ndonëse me shumë gjasë i kanë finalizuar dokumentet buxhetore, por nuk i publikojnë ato në mënyrë të rregullt.
- Megjithëse fryma e bazës ligjore aktuale inkurajon komunat të organizojnë dëgjime buxhetore, dhe ndonëse shumë prej tyre tashmë e bëjnë këtë në praktikë, dispozitat ligjore duhet të jenë më të qarta dhe më të detajuara. Ato duhet të rrisin nivelin minimal të kërkuar dhe të përcaktojnë një numër të detyrueshëm e përfaqësues dëgjimesh publike që komunat janë të obliguara të mbajnë lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe projektbuxhetin, me qëllim të sigurimit të një pjesëmarrjeje të qytetarëve në këto procese të rëndësishme. Brenda kësaj, është e nevojshme të përcaktohet qartë numri minimal i dëgjimeve buxhetore që duhet të organizohen si nga dega ekzekutive edhe nga ajo e kuvendit komunal.
- Komunat t'i kushtojnë rëndësi publikimit të dokumenteve lidhur me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinnor, marrë parasysh edhe rëndësinë që ka përdorimi i tyre në ndërtimin e politikave nga komuna, dhe të pasurojnë përmbajtjen e tyre përtej obligimeve bazike të kërkuara sipas qarkoreve buxhetore.

Aneks

Vlerësimi i detajuar për secilën komunë sipas rangimit dhe renditjes alfabetike.

Kaçanik	17
Klinë	18
Lipjan	19
Mitrovicë e Jugut	20
Prizren	21
Rahovec	22
Shtime	23
Skënderaj	24
Vushtrri	25
Drenas	26
Hani i Elezit	27
Podujevë	28
Viti	29
Istog	30
Suharekë	31
Dragash	32
Prishtinë	33
Deçan	34
Mitrovicë e Veriut	35
Junik	36
Kamenicë	37
Pejë	38
Malishevë	39
Gjilan	40
Gjakovë	41
Ferizaj	42
Obiliq	43
Fushë Kosovë	44
Partesh	45
Novobërdë	46
Mamushë	47
Shtërpcë	48
Ranillugë	49
Graçanicë	50
Leposaviq	51
Klllokot	52

Kaçanik

Komuna e Kaçanikut është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Të gjitha dokumentet e vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 5. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027	10			
Kontratat e nënshkruara 2024			10	
Gjithsej				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:
100

Klinë

Komuna e Klinës është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Përveç kontratave të nënshkruara, të gjitha dokumentet tjera buxhetore të vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 6. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve		5		
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027	10			
Kontratat e nënshkruara 2024			10	
Gjithsej				
<i>Buxheti i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:
100

Lipjan

Komuna e Lipjanit është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Përveç kontratave të nënshkruara dhe rregullorës për ndarjen e subvencioneve, të gjitha dokumentet tjera buxhetore të vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 7. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027	10			
Kontratat e nënshkruara 2024			10	
Gjithsej				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:
100

Mitrovicë e Jugut

Komuna e Mitrovicës së Jugut është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Përveç kontratave të nënshkruara dhe rregullorës për ndarjen e subvencioneve, të gjitha dokumentet tjera buxhetore të vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 8. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve				
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027	10			
Kontratat e nënshkruara 2024			10	
Gjithsej				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:
100

Prizren

Komuna e Prizrenit është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Përveç kontratave të nënshkruara dhe rregullorës për ndarjen e subvencioneve, të gjitha dokumentet tjera buxhetore të vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 9. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0		5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025–2027	10			
Kontratat e nënshkruara 2024			10	
Gjithsej				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✘			

Indeksi:
100

Rahovec

Komuna e Rahovecit është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Përveç kontratave të nënshkuara, të gjitha dokumentet tjera buxhetore të vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 10. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027	10			
Kontratat e nënshkuara 2024			10	
Gjithsej				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✘			

Indeksi:
100

Shtime

Komuna e Shtimës është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Përveç kontratave të nënshkruara dhe rregullorës për ndarjen e subvencioneve, të gjitha dokumentet tjera buxhetore të vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 11. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve		5		
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025			2.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027	10			
Kontratat e nënshkruara 2024			10	
Gjithsej				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:
100

Skënderaj

Komuna e Skënderajt është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Përveç kontratave të nënshkuara dhe rregullorës për ndarjen e subvencioneve, të gjitha dokumentet tjera buxhetore të vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 12. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0		5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027	10			
Kontratat e nënshkuara 2024			10	
Gjithsej				
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:
100

Vushtrri

Komuna e Vushtrrisë është ndër performueset më të mira në Indeksin e Transparencës Buxhetore për vitin 2024, duke arritur pikët maksimale (100 pikë) dhe duke u renditur në kuartilin e lartë. Përveç kontratave të nënshkuara, të gjitha dokumentet tjera buxhetore të vlerësuara në kuadër të indeksit janë të publikuara në formate të qasshme si 'Excel' ose 'Word', duke lehtësuar analizën dhe përdorimin nga qytetarët dhe palët e interesit.

Tabela 13. Vlerësimi i detajuar për dokumentet buxhetore

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	PDF i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2024	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2024	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2024	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2025	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2024	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2024	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2025	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2025–2027	10			
Kontratave të nënshkuara 2024			10	
Gjithsej				
